



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Kryetari i Komunës
01Nr. 104/02-23635/2025
Kaçanik, 18.09.2025

Thirrje publike për shprehje të interesit për të qenë pjesë e komisioneve vlerësuese për vlerësimin e Projekt -Propozimeve të OJQ-ve

Komuna e Kaçanikut, sipas Thirrjes Publike 01Nr.104/02-22216/25 e datës 03.09.2025, për aplikim për subvencione në fushën e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për vitin 2025, planifikon të ofrojë mbështetje financiare për implementimin e projekteve të organizatave joqeveritare në fushat prioritare që ndërlidhen me zhvillimin e aktiviteteve këshilluese, avokuese dhe ofrimin e drejtpërdrejtë të shërbimeve sociale dhe familjare

Rregullorja MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në nenin 8, paragrafi 3.2 parasheh që pjesë e çdo komisioni vlerësues për vlerësimin e projektpropozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas thirrjeve publike, duhet të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, njëri nga të cilët duhet të jetë përfaqësues i OJQ-ve, si dhe rregullores Nr.06/2016 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve. Për këtë qëllim, Komuna e Kaçanikut, fton të gjithë kandidatët e interesuar që të aplikojnë për të qenë pjesë e regjistrit të ekspertëve të jashtëm, të cilët sipas nevojës së institucionit do të caktohen në cilësinë e anëtarëve në komisione vlerësuese për të vlerësuar projekt -propozimet e dorëzuara nga OJQ-të për financim përmes fondeve publike.

Të drejtë aplikimi kanë:

- Të punësuarit në organizatat joqeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë të pavarur, të cilët kanë të paktën 1 vite përvojë pune që ndërlidhet me administratën publike, hartimin dhe menaxhimin e projekteve apo fusha të ngjashme.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve Bachelor;
- Të kenë të paktën 1 vite përvojë pune ;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;
- Të mos jenë të emëruar politikë, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- Një letër motivimi;
- Një CV të përditësuar;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;

Aplikimi mund të bëhet nga data 18.09.2025 deri më datë 24.09.2025 duke dorëzuar një kopje fizike të dokumentacionit të kërkuar në objektin e Komunës së Kaçanikut, Zyra pritëse (sporteli nr. 5)

Komuna e Kaçanikut, do të vlerësoj të gjitha aplikacionet e pranuar dhe kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes kësaj thirrje publike, do të bëhen pjesë e regjistrit të ekspertëve të jashtëm të cilët do të ftohen sipas nevojës për të qenë pjesë e komisioneve vlerësuese sipas thirrjeve publike që do të bëjë Komuna e Kaçanikut në kuadër të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale gjatë vitit 2025.

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi